

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

SIGKOS Sh.a.

31 dhjetor 2017

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	2
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e pozicionit financiar	5
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Shënimet e pasqyrave financiare	8
Shtojcë	

3. Siç shpjegohet më tej në shënimin 16 dhe 17 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 dhjetor 2017, kompania ka kryer rivlerësimin e pronës, pajisjeve dhe pasurisë së paprekshme. Vlera e drejtë u përcaktua nga vlerësues të pavarur profesional dhe rezultatet e rivlerësimit u njohën si një rritje e llogarisë së rezervave të rivlerësimit për shumën totale prej 198,301 euro. Ne nuk ishim në gjendje të bindemi në lidhje me metodologjinë e përdorur për përcaktimin e vlerave të drejta të pronës, pajisjeve dhe pasurive të paprekshme, si dhe vlerësimin e jetës së dobishme të mbetur. Rrjedhimisht, nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime të kësaj shume më 31 dhjetor 2017. Përveç kësaj, rregullimet e mundshme do të ndikojnë në llogaritjen e fondit të garancisë më 31 dhjetor 2017.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga entiteti në përputhje me "Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë" të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi BSNEK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me Kodin e IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

Theksim i çështjeve

Ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

1. Siç shpjegohet në Shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, në përputhje me Rregulloren për Investimin e Pasurive që mbulojnë provizionet teknike dhe matematike dhe investimin e kapitalit themeltar për siguruesit e lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), të gjitha shoqëritë e sigurimeve janë detyruar të mbajnë pasuritë që mbulojnë provizionet teknike prej 70% më 31 dhjetor 2017. Më 31 dhjetor 2017, pasuritë që mbulojnë provizionet teknike rezultojnë në 2,149,246 euro, që përfaqësojnë 64% të provizioneve teknike.
2. Siç shpjegohet më tej në Shënimin 4 të pasqyrave financiare shoqëruese, në pajtim me Rregulloren për llogaritjen e minimumit të aftësisë paguese, mjaftueshmërinë e kapitalit dhe fondin e garancisë për siguruesit jo-jetë të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK"), kapitali i siguruesve që ushtrojnë veprimtari me klasat e sigurimeve të jo-jetës dhe kapitalin e siguruesve që ushtrojnë veprimtari në fushën e risigurimeve nuk duhet të jetë më e ulët se niveli i kërkuar i aftësisë paguese të siguruesve. Më 31 dhjetor 2017, Kompania ka deficit në fondin e garancisë në shumën prej 1,273,613 euro.

Përveç kësaj, nëse ndonjë rregullim do të ishte njohur si rezultat i kufizimeve të qëllimit tonë të përcaktuar në paragrafët e Bazat për Opinion të Kualifikuar, deficitin në fondin e garancisë mund të kishte qenë më i lartë.

Opinionin ynë nuk është kualifikuar më tej në lidhje me çështjet e përmendura më sipër.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të dhe rregulloret e BQK-së dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti përcakton është i domosdoshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompanisë për të përmbushur hipotezën e vijimësisë, duke shpalosur, sipas rastit, çështjet që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e biznesit dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit për të përmbushur hipotezën e vijimësisë, përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka alternativë reale, por ta bëjë këtë.

Ata të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë ofrimi i sigurisë së arsyeshme në lidhje me çështjen se a janë pasqyrat financiare të lira nga gabimet materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimit dhe lëshimi i një raporti të auditorit që përmbanë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit do të zbulojnë gabimet materiale nëse ato ekzistojnë. Gabimet mund të ndodhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse individualisht apo në tërësi pritet që të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve që bazohen në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit, në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare që vijnë si rezultat i gabimit apo mashtrimit, dizajnojmë dhe performojmë procedurat e auditimit në lidhje me ato risqe dhe mbajmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazën për opinionin tonë. Risku i moszbulimit të gabimeve materiale nga mashtrimet është më i lartë se sa ai i gabimit për shkak se risku i mashtrimit mund të përmbajë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo refuzime të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollet e brendshme që janë relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Kompania të mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar t'i kushtojmë vëmendje në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Kompania të pushojë së përmbushuri hipotezën e vijimësisë.
- Vlerësimin e prezentimit, strukturës dhe përmbajtjes së përgjithshme të pasqyrave financiare duke përfshirë shpalosjet dhe nëse pasqyrat financiare prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të angazhuar me qeverisjen, përpos çështjeve të tjerave, për shtrirjen, kohëzgjatjen dhe gjetjet e auditimit duke përfshirë mangësitë e mëdha eventuale në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në anglisht, në rast mospërputhje do të mbizotëroje versionin në gjuhën angleze.

Grant Thornton LLC
Grant Thornton LLC

Pristinë, Kosovë

27 prill 2018

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse


	Shënime	Viti që përfundon më 2017	në euro 31 dhjetor 2016
Primi i shkruar bruto	6	1,907,150	2,080,189
Minus: taksa mbi primin		(107,008)	(114,425)
Minus: Primin e ceduar ne risigurim		(147,744)	(62,912)
Primi i shkruar neto nga taksa mbi primin		1,652,399	1,902,852
Ndryshimi neto në rezervën për primin e pafiturar		191,356	(97,651)
Primi i fituar neto nga taksa mbi primin		1,843,754	1,805,201
Të ardhura nga Byroja e Sigurimit të Kosovës (BKS)	7	233,002	208,318
Të ardhura nga interesi, neto	8	85,661	93,591
Të ardhurat tjera	9	158,852	557,470
Totali të ardhurave		2,321,270	2,664,580
Humbjet dhe shpenzimet e dëmeve pezull	20	(758,584)	(1,006,547)
Shpenzime për Byronë e Sigurimit të Kosovës (BKS)	7	(176,406)	(216,145)
Kontributet për Fondin e kompensimit	10	(114,258)	(114,597)
Shpenzime të marketingut dhe administrative	11	(1,603,526)	(1,535,645)
Totali i shpenzimeve		(2,652,774)	(2,872,934)
(Humbja) për vitin		(331,505)	(208,354)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			
<i>Cështjet që nuk do të riklasifikohen në profit humbje</i>			
Rivlerësimi i objekteve	16	198,301	-
Totali të ardhurave (humbjeve) gjithëpërfshirëse		(133,204)	(208,354)


Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2017

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	2017	në euro Më 31 Dhjetor 2016
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	12	689,002	347,615
Depozitat	13	3,745,183	4,015,183
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	14	107,846	188,731
Kosto e shtyrë e marrjes në sigurim	15	168,708	234,395
Asetet e risigurimit	20	108,611	108,611
Toka dhe paisjet	16	782,237	651,970
Pasuritë e paprekshme	17	55,000	5,166
Pasuritë tjera afatshkurtra	18	1,158,531	1,579,666
Totali i pasurisë		6,815,118	7,131,337
Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali			
	19		
Kapitali aksionar		3,406,850	3,406,850
Rivlerësimi i reserves		221,398	23,097
Humbje të akumuluar		(421,785)	(90,280)
Totali i kapitalit		3,206,463	3,339,667
Detyrimet			
Rezerva e dëmeve pezull	20	2,280,802	2,266,586
Rezerva e primit të pafitur	21	1,072,310	1,263,665
Hua afatshkurtër/afatgjata	22	25,051	33,311
Detyrime të tjera	23	230,493	228,108
Totali i detyrimeve		3,608,655	3,791,670
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		6,815,118	7,131,337

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti më 23 prill 2018, dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


Zt. Ibrahim Kastrati
Drejtor i përgjithshëm


Znj. Alisa Bejta
Drejtor Finance

Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2017

Pasqyra e ndryshimeve në Ekuitet

	në euro			
	Kapitali aksionar	Rezervat e rivlerësuara	Humbje të akumuluar	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	3,406,850	23,097	(90,280)	3,339,667
<u>Transaksione me aksionarët</u>	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	-	(331,505)	(331,505)
<u>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</u>				
Rivlerësimi i pronave dhe paisjeve dhe softuerëve (Shënimi 16 dhe 17)	-	198,301	-	198,301
Totali i të ardhurave (humbja) gjithëpërfshirëse	-	198,301	(331,505)	(133,204)
Më 31 dhjetor 2017	3,406,850	221,398	(421,785)	3,206,463
Gjendja më 1 janar 2016	3,406,850	23,097	118,074	3,548,021
<u>Transaksione me aksionarët</u>	-	-	-	-
Humbja e vitit	-	-	(208,354)	(208,354)
<u>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</u>	-	-	-	-
Rivlerësimi i objekteve (Shënimi 16)	-	-	-	-
Totali i të ardhurave (humbja) gjithëpërfshirëse	-	-	(208,354)	(208,354)
Më 31 dhjetor 2016	3,406,850	23,097	(90,280)	3,339,667

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e rrjedhës së parasë

	Shënime	Viti që përfundon më 31 dhjetor 2017	në euro Viti që përfundon më 31 dhjetor 2016
Aktivite operative			
Humbja neto për vitin		(331,505)	(208,354)
<i>Korrigjime për zërat jo monetare:</i>			
Zhvlërësimi dhe amortizimi	16, 17	31,719	36,381
Humbja nga dëmtimi i të arkëtueshmeve nga sigurimet dhe të arkëtueshmet tjera	11	386,437	195,479
Lirimi nga zhvlërësimi i provizionit për të arkëtueshmet e shlyera më parë	9	(118,681)	(146,632)
Të hyrat nga shitja e veturave	9	(6,375)	-
Të ardhurat nga interesi	8	(95,179)	(103,990)
		(133,584)	(227,116)
<i>Ndryshime në asetet operative</i>			
Të arkëtueshmet nga sigurimi		68,945	(6,975)
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim		65,687	(40,557)
Asetet tjera afatshkurtëra		133,925	(204,688)
		134,973	(479,336)
<i>Ndryshimet në detyrimet operative</i>			
Humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjeve (rezervat teknike)		14,216	65,655
Provizonimi për primet e pafituara		(191,355)	97,651
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		(5,876)	(19,977)
Neto paraja (e përdorur) / gjeneruar nga aktivitet operative		(48,042)	(336,007)
Aktivitet investive			
Blerja e pronës dhe paisjeve		(1,534)	(6,470)
Blerja e asetëve të paprekshme		(13,810)	(5,000)
Rritja në depozita		(2,293,736)	(1,059,333)
Zvogëlimi në depozita		2,543,736	1,226,000
Interesi i arkëtuar		134,773	128,984
Neto paraja (e përdorur) në aktivite investive		369,429	284,181
Aktivitet financuese		-	-
Neto paraja (e përdorur) në aktivite financuese		-	-
Neto ndryshimet në para dhe në ekuivalentët e parasë		321,387	(51,826)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		47,615	99,441
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	12	369,002	47,615

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare